



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**ANALIZA E PERFORMANCËS
JANAR – MARS 2021**

Tabela e Përmbajtjes:

KREU I- ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR - MARS 2020

1. Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.....	4
2. Ndihma Juridike Parësore.....	4
2.1 Hapja e qendrave të reja të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	4
2.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.....	6
2.3 Financimi i Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.....	8
3 Ndihma Juridike dytësore.....	9
3.1 Lidhja e kontratave me avokatët ofrues të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021.....	9
4 Mbajtja, mbledhja, plotësimi dhe administrimi i të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike parësore dhe dytësore.....	10
5 Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike.....	11
5.1 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	11
5.2 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike dytësore.....	14
6 Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike.....	14
6.1 Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura.....	14
6.2 Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere/ edukimit ligjor të publikut.....	15
7. Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.....	16
8. Kontribute të DNJF në kuadër të raportimeve për Bashkimin Evropian.....	17
9. Angazhim i DNJF në kuadër të dokumentave strategjik.....	18
10. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse (UNDP/EURALIUS/OSFA).....	19

KREU II -RAPORTIMI DHE MENAXHIMI FINANCIAR.....22

KREU III -PËRFUNDIME.....25

Bashkëlidhur:

- *Analizë statistikore mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore për muajin Mars 2021, si dhe shtojca me të dhënat statistikore për periudhën Janar-Shkurt 2021;*
- *Kalendari i mbikëqyrjes së ofruesve të shërbimit për vitin 2021.*

Në mbështetje të shkronjës “b” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ku përcaktohet se: “Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i paraqet Ministrit të Drejtësisë raporte tremujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike”, u hartua raportimi tre mujor Janar-Mars 2021.

Ky raport përmbledh detyrimet funksionale dhe obligimet që rrjedhin nga ligji nr. 111/2017, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë si dhe dokumentat strategjke në të cilat DNJF është e përfshirë, të ndara respektivisht sipas krerëve.

KREU I- ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR - MARS 2021

1. Funkcionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri, me Urdhër nr. 59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndhmës Juridike Falas” me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Që prej Nëntorit të vitit 2019, DNJF ka funksionuar me një staf të reduktuar prej 11 specialistësh, njëri prej të cilëve në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të komanduar të Drejtorisë.

Në korrik të vitit 2020, me Urdhër nr. 201, datë 01.7.2020, të Ministrit të Drejtësisë është emëruar Z. Ergys Qirici në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF (TND). Për tre drejtorët e drejtorive të ndhmës juridike, kemi vijuar në mënyrë të përsëritur me komunikimet me Departamentin e Administratës Publike me qëllim shpalljen e vendeve vakante dhe përfundimin e procedurave të rekrutimit.

Në Shkurt të vitit 2021, është bërë i mundur rekrutimi i vendeve vakante të DNJF përfshirë këtu edhe stafin drejtues duke mundur realisht të këtij objekti në masën 100%.

2. Ndihma Juridike Parësore

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
- c) klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritet kyçe të DNJF. Përgjatë kësaj periudhe DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP; OSFA apo EURALIUS me qëllim nxitjen e sistemit të ndihmës juridike parësore.

2.1 Hapja e qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në kompetencën e caktuar në nenin 8, pika gj) DNJF administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

Në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF ka vijuar me procedurat e hapjes së qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytete të cilat, kanë më shumë nevoja për këtë natyrë shërbimi. Aktualisht DNJF administron 10 (dhjetë) qendra në bashkëpunim

me OSFA dhe UNDP në qytetin e Tiranës; Durrësit, Fierit, Lezhës, Shkodrës, Lushnjës, Pogradecit, Gjirokastrës si dhe Qendrën më të re në qytetin e Vlorës.

Përgjatë periudhës Janar-Mars 2021 është bërë e mundur hapja/rivitalizimi i 3 qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Fier, Vlorë dhe Dibër (me mbështetjen e UNDP).

- Mbi qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Fier

Me miratimin e propozimit për kalimin nën administrim, nga ana e DNJF u ndërmorrën masa sa i përket amendimit të marrëveshjes me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier ku kjo qendër ka qenë funksionale, por kjo mundësi ishte e pamundur.

Si pasojë, nga ana e DNJF u ndërmorrën kontaktet me ADISA Fier dhe u mundësua lidhja e marrëveshjes nr. 632/1 prot., datë 09.12.2020, “Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundërshpërblim” si dhe rekrutimit të 1 punojësi me trajnim të posaçëm¹ me të cilët DNJF mban kontakt të vazhdueshëm qoftë për sa i përket rasteve të trajtuara, qoftë për sa i përket orientimit të punonjësve mbi mbajtjen e kontakteve me institucionet vendore dhe ofruesit e tjerë të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qarkun e Fierit në kuadër të krijimit dhe bërjes funksional të rrjetit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike falas.

Nga analizat statistikore mujore që DNJF prodhon dhe publikon në baza mujore, rezulton se që prej muajit të rivitalizimit të kësaj në Mars të vitit 2021, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier ka trajtuar **14 raste** ndër të cilat **8 raste** të trajtuara me aplikantë femra dhe **6 raste** ku aplikantët përfitues ka qenë meshkuj.

Në muajin Shkurt 2021, ekipi i DNJF në bashkëpunim me punonjësën me trajnim të posaçëm të qendrës Fier organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Prokuroria; Bashkia; etj si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike. Gjithashtu, nga ana e DNJF janë ndërmarrë masat për orientimin e punonjësve me trajnim të posaçëm si dhe monitorimin e cilësisë së shërbimit përmes monitorimeve fillestare dhe të vazhdueshme mbi të cilat do të parashtrohet në vijim të këtij raportimi.

- Mbi qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Vlorë

Hapja e qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore Vlorë, si një qark me një numër popullsie relativisht të lartë dhe të pambuluar nga ofrues të tjerë të shërbimit të ndihmës juridike parësore do të ketë një impakt relativisht të lartë në kuadër të mbulimit të qytetarëve me shërbime ligjore falas.

Si një vendndodhje strategjike për hapjen e kësaj qendre, duke marrë në konsideratë aksesin nga qytetarët, nga ana e DNJF dhe UNDP u propozua hapja e kësaj qendre pranë ambienteve të Bashkisë Vlorë.

DNJF ka patur një korreponcencë të gjatë me Bashkinë Vlorë, në kuadër të mundësisë për vendosjen në dispozicion të një ambienti pa kundërshpërblim. Më datë 10.03.2021, pas një takimi të DNJF me

¹ <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/vende-vakante/>

përfaqësues të Bashkisë Vlorë, u bë e mundur vendosja në dispozicion e një ambienti në katin 0 të Bashkisë, për t'u përdorur si qendër e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Ambienti disponon një hapësirë të bollshme dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga qytetarët dhe veçanërisht personat me aftësi të kufizuara. Ky ambient do të jetë në dispozicion deri në krijimin e Zyrës me një Ndalesë pranë Bashkisë Vlorë në të cilën qendra do të ketë hapësirën e saj të dedikuar.

Që prej datës 10 Mars 2021, punonjësit e qendrës janë sistemuar pranë ambientit të dakordësuar dhe po vijnë me promovimin e qendrës përmes shpërndarjes së materialeve të vizibilitetit dhe vendosjes së kontakteve pranë gjykatave dhe institucioneve të pushtetit vendor. Gjithashtu, nga ana e DNJF janë ndërmarrë masat për orientimin e punonjësve me trajnim të posaçëm si dhe monitorimin e cilësisë së shërbimit përmes monitorimeve fillestare dhe të vazhdueshme mbi të cilat do të parashtrohet në vijim të këtij raportimi.

- **Mbi qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Dibër**

Me miratimin e propozimit për kalimin nën administrim, nga ana e DNJF u ndërmorrën masa sa i përket amendimit të marrëveshjes me nr. 506/1 prot., datë 05.11.2020, me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër (*ku kjo qendër ka qenë më parë funksionale*)² si dhe rekrutimit të 1 punonjësi me trajnim të posaçëm³ me të cilët DNJF mban kontakt të vazhdueshëm qoftë për sa i përket rasteve të trajtuara, qoftë për sa i përket orientimit të punonjësve mbi mbajtjen e kontakteve me institucionet vendore dhe ofruesit e tjerë të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qarkun e Durrësit në kuadër të krijimit dhe bërjes funksional të rrjetit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike falas.

Nga analizat statistikore mujore që DNJF prodhon dhe publikon në baza mujore, rezulton se që prej muajit të fillimit të funksionimit në Mars të vitit 2021, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Dibër, ka trajtuar **15 raste** ndër të cilat **10 raste** të trajtuara me aplikantë femra dhe **5 raste** ku aplikantët përfitues kanë qenë meshkuj.

Nga ana e DNJF janë ndërmarrë masat për orientimin e punonjësve me trajnim të posaçëm si dhe monitorimin e cilësisë së shërbimit përmes monitorimeve fillestare dhe të vazhdueshme mbi të cilat do të parashtrohet në vijim të këtij raportimi si dhe nevojës për promovimin e qendrës dhe vendosjes së kontakteve me institucionet vendore dhe ofruesve të tjerë të shërbimit.

2.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me qëllim ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, “*Klinikë ligjore*” është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

² Marrëveshja nr. 503/1 prot., datë 05.11.2020 “Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundërshtim për tu përdorur si qendër e shërbimit të ndihmës juridike parësore”

³ <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/vende-vakante/>

Aktualisht DNJF ka lidhur marrëveshje me 10 Institucione të Arsimit të Lartë dhe konkretisht:

1. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Universitetin Marin Barleti*”;
2. Marrëveshje Bashkëpunimi me *Fakultetin e Drejtësisë*;
3. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Bedër*”;
4. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Wisdom*”;
5. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Universitetin European të Tiranës*”;
6. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Aleksandër Moisiu Durrës*”;
7. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Ismail Qemali Vlorë*”;
8. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Qiriazi*”;
9. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (*Klinika e Ligjit Shkodër*);
10. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Universitetin Marin Barleti*”.

Marrëveshja më e fundit e Bashkëpunimit është lidhur më datë 21.01.2021, mes Ministrit të Drejtësisë dhe përfaqësuesit të Universitetit Marin Barleti, pasuar edhe me një aktivitet promovues të Klinikës.

Përgjatë periudhës 3 mujore, DNJF ka patur një kontakt të vazhdueshëm me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit në kuadër të zhvillimit të takimeve/trajnimeve si dhe angazhimit të studentëve në praktika 3 mujore pune pranë DNJF dhe Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, të parashtruara konkretisht si vijon:

- *Aktiviteti “Garantimi i ndihmës juridike parësore nëpërmjet ofrimit të këtij shërbimi nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve”, me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë; studentëve dhe përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit. (Janar 2021)*

Më datë 26.01.2021, u zhvillua takimi i përbashkët me të gjithë përfaqësuesit e Klinikave të Ligjit dhe studentët e angazhuar pranë këtyre Klinikave.

Ky takim u hap me fjalën e Ministrit të Drejtësisë e cila u shpreh mbi rëndësinë e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve si ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore, të cilat shërbejnë për informimin e qytetarëve për legjislacionin shqiptar, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar, por edhe çështje të cilat lidhen me ndërmjetësimin, këshillimin, përpilimin e akteve, përfaqësimin pranë organeve të administratës shtetërore si dhe shërbime të tjera. Takimi vijoi me ndërveprimin ndëraktiv të përfaqësuesve të Klinikave të Ligjit si dhe studentët të cilët shfaqën një interes të lartë sa i përket zhvillimit të trajnimeve dhe angazhimit në praktikat e punës me qëllim përfitimin e njohurive më praktike mbi sistemin e ndihmës juridike parësore.

- *Vizitë pranë Klinikës së Ligjit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës me pjesëmarrjen e Zv.Ministrit të Drejtësisë, Z.Karameta. (Shkurt 2021)*

Zv.Ministri i Drejtësisë Z. Klajd Karameta dhe ekipi i Drejtorisë së Përgjithshme të Ndhmës Juridike inspektuan Klinikën e Ligjit pranë këtij Universiteti për të parë nga afër veprimtarinë këtij institucioni që është krijuar si risi. Në këtë vizitë, u zhvillua dhe një takim edhe me Dekanin e këtij Universiteti, takim në të cilin u prezantuan arritjet e deritanishme të kësaj Klinike si dhe bashkëpunimin më tej me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

- *Trajnim i studentëve të angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve (Shkurt 2021)*

Stafi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me temë “Aksesi në drejtësi dhe risitë e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, mbajtur me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Në këtë takim online u trajtuan temat: “Instrumentët ndërkombëtarë që garantojnë aksesin në drejtësi të qytetarëve ndërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas; Sistemi i ndihmës juridike parësore; Sistemi i ndihmës juridike dytësore; Arritjet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmes si dhe parashtrimi i rasteve praktike nga punonjësit i Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë”.

Në fund të këtij aktiviteti studentët u pajisën me një vërtetim pjesëmarrjeje si dhe ju bë me dije mundësia për aplikim në kuadër të praktikave 3 mujore të punës (Prill-Qershor 2021) pranë DNJF si dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

- Hapja e thirrjes për zhvillimin e praktikave të punës pranë DNJF dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (Mars 2021)

Ne permbushje te detyrave funksionale te percaktuara ne ligjin nr. 111/2017, dhe konkretisht ne nenin 16 ku percaktohet se: “Drejtoria e Ndhmes Juridike Falas, bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore” nga ana e DNJF jane ndërmarrë masat për angazhimin e studenteve në praktika pune pranë Drejtorisë sonë si dhe Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, për një periudhë 3 mujore (Prill-Qershor 201). Nga aplikimet kanë shfaqur interesin mbi 30 studentë nga qytete të ndryshme të RSH.

2.3 Financimi i Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.

Bazuar në nenin 15, pika 3 e Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

organizatat jofitimprurëse të autorizuara për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje.

Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuara, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen në VKM Nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”.

Në përmbushje të përcaktimeve të VKM nr. 110/2019, DNJF vijoi me shpalljen e thirrjes për aplikime për financim më datë **01 Mars 2021**, thirrje e cila mbetet e hapur deri më **15 Prill 2021**, përmes hapave kryerjes së hapave proceduralë si vijon:

1. Hartimi i Planit Vjetor të Financimit dhe publikimi i tij në faqen zyrtare të DNJF sipas përcaktimeve të pikës 4 të VKM nr. 110/2019;
2. Miratimi me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm i dokumentave të unifikuara të aplikimit (shtojca nr. 1; 2; 3; 4) dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të DNJF sipas përcaktimeve të pikës 5 të VKM nr. 110/2019;
3. Shkresa me nr. 239 prot., datë 01.03.2021, me lëndë: *“Kërkesë për publikimin e thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuarra për ofrimin e ndihmës juridike parësore”* drejtuar Qendres së Botimeve Zyrtare;
4. Shkresa me nr. 239/prot date 01.03.2021, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me lëndë: *“Mbi hapjen e procedurave të aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti I shtetit të organizatave jofitimprurëse të autorizuarra për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”*, nëpërmjet të cilës kërkohet ndërmarrja e masave për caktimin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit dhe Komisionit të Ankimit sipas përcaktimeve të VKM nr. 110/2019;
5. Shkresa me nr: 248 prot., date 03.03.2021, drejtuar 12 Organizatave Jofitimprurëse të autorizuarra, me qëllim informimin mbi hapjen e thirrjes për financim *(dërguar njekohësisht dhe me email)*;
6. Shkresa me nr. 239/2 prot., datë 31.03.2021, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me lëndë: *“Përcillen emrat e anëtarë të DNJF për pjesëmarrje në Komisionin e Vlerësimit dhe Komisionin e Ankimit”*.

Mbetemi në pritje të përfundimit të afatit të aplikimit me qëllim ngritjen e Komisioneve; Sekretariatit Teknik si dhe shqyrtimin e aplikimeve brenda afatit 10 ditor nga përfundimi i datës së aplikimit sipas përcaktimeve të VKM nr. 110/2019.

3. Ndihma juridike dytësore

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, Ligjit nr.111/2017.

Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenin 8 të ligjit Nr. 111/2017, gërma k) DNJF lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

Në muajin Janar, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative për vitin 2021. Gjatë kësaj procedure është respektuar parimi i rotacionit si dhe të gjitha rregullat e parashikuara në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, me nr.17, datë 05.08.2020, duke garantuar kështu një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Pas miratimit të listës së avokatëve që do të ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore nga DhASH, DNJF vijoi me procesin e lidhjes së kontratave me avokatët e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për vitin 2021.

Lista e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike falas është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe aktualisht, për vitin 2021 kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore **124 avokatë**.

Gjithashtu, DNJ në përmbushje të detyrave të saj funksionale të parashikuara në nenin 22 të ligjit 111/2017, po vijon me ndjekjen e vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore dhe ose përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Pas analizës së vendimeve, DNJF procedon me ankimimin e tyre nëse kërkesat me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore janë dukshëm abuzive ose haptazi të pabazuara.

Gjithashtu janë kryer 5 pagesa të detyrimeve kontraktuale me avokatët që kanë ofruar ndihmë juridike dytësore.

Për sa i përket detyrimeve të përcaktuara në nenin 31 të ligjit: *Rastet e kthimit të përfitimeve në rast se një person, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, i kanë ndryshuar rrethanat në një mënyrë të tillë që nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë subjekt përfitues i ndihmës juridike dytësore*, apo detyrimit të përcaktuar në nenin 32 të ligjit, *Rimbursimi në rastin e dhënies së informacioneve të rreme ose të pavërteta*, DNJF për periudhën Janar-Mars 2021, pas verifikimit të vazhdueshëm të çështjeve gjyqësore, nuk ka konstatuar asnjë rrethanë apo indicie që mund të përfshijë rastet e përcaktuara në nenin 31 dhe 32 të ligjit.

4. Mbajtja, mbledhja, plotësimi dhe administrimi i të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve

Bazuar në nenin 8 të ligjit të sipërcituar, DNJF:

- a) *administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.*
- b) *mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj.*

Bazuar në këtë dispozitë, me udhëzimin nr.1, datë 08.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “*Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave*” janë përcaktuar në mënyrë të detajuar të dhënat që çdo qendër e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të raportojë.

Konkretisht, në pikën 3 të këtij udhëzimi përcaktohet shprehimisht se: “*Çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti i dërgon periodikisht çdo muaj Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, të dhënat e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve kërkuese të paraqitura për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Të dhënat dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues*”

Plotësimi dhe përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti kryhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i depozitimit të informacionit pranë DNJF, sipas pikes 3 të këtij udhezimi. Referuar udhëzimit të sipërcituar, DNJF ka hartuar një format raportimi tip i cili përcillet nga të gjithë ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Bazuar nga të dhënat e administruara, personat e autorizuar pranë DNJF po vijojnë me administrimin në mënyrë të detajuar të të gjitha të dhënave të çështjeve me objekt dhënien e ndihmës juridike parësore apo dytësore duke i administruar ato në një database të dedikuar.

5. Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes

5.1 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore

Një komponent shumë i rëndësishëm i ofrimit të ndihmës juridike falas është cilësia e këtij shërbimi. Shërbimi i ndihmës juridike falas quhet së është garantuar në mënyrë të plotë, me eficiencë dhe efektivitet vetëm atëherë kur është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendja e duhur kombinimit të shifrave sasiore me të dhënat e cilësisë së shërbimit. Kombinimi i të dhënave statistikore me cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, si pjesë e një pakete unike shërbimi dedikuar qytetarit.

Referuar Ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në nenin 8 të tij, përcaktohet si një ndër detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas: Zbatimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyrja çdo vit e standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët.

Në zbatim të këtyre parashikimeve, me Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”, është miratuar metodologjia që do të ndiqet për të vlerësuar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve të ofruara të ndihmës juridike.

Për të përmbushur qëllimet e përfunduara në ligj, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike, është drejtoria e krijuar brenda Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas që ka përgjegjësinë e kryerjes së monitorimeve fillestare dhe të vazhdueshme në funksion të vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Krijimi i një sistemi të ndihmës juridike falas i cili siguron akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; mirorganizimi, miradministrimi dhe mirëfunksionimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike si dhe garantimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive janë disa nga qëllimet kryesore të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Këto qëllime shërbejnë si udhëzues të mënyrës si kryhet monitorimi i cilësisë së shërbimit, procesi i cili detajohet në Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Sistemi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti vjen tashmë në formën e një rrjeti institucionesh të veshura me përgjegjësinë e garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi. Është përgjegjësia e këtyre institucioneve të bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve juridike falas me cilësi dhe profesionalizëm. Nëse një nga institucionet, mekanizmat e krijuara nuk bashkëpunon në format e kërkuara nga ligji, rrjedhimisht i gjithë sistemi i ndihmës juridike has në vështirësi që ndikojnë drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimit kundrejt qytetarëve në nevojë.

Monitorimi dhe kontrolli që kryhet për të gjithë ofruesit e ndihmës juridike të garantuar nga shteti synon të konstatojë mënyrën e ofrimit të shërbimit; zgjidhjen e problematikave; trajtimin e personave përfitues; cilësinë dhe profesionalizmin gjatë trajtimit dhe ndjekjes së çështjes dhe në fund synon të japë disa rekomandime të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë dhe eficiencës në punë.

Monitorimet tre-mujore të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

Qendra e Shërbimit	Monitorimi tre-mujor
Qendra Durrës	16.03.2021 (kryer)
Qendra Lezhë	24.03.2021 (kryer)
Qendra Gjirokastrë	Prill 2021 (planifikuar)
Qendra Shkodër	Maj 2021 (planifikuar)
Qendra Dibër	Qershor 2021 (planifikuar)
Qendra Vlorë	Qershor 2021 (planifikuar)
Qendra Fier	Qershor 2021 (planifikuar)

Monitorimet u kryen nga grupi i mbikëqyrjes me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhrin nr.531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Monitorimet u ushtruan duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë, dhe efektivitetit.

Nga monitorimi dhe komunikimi i vazhdueshëm me qendrat **kanë rezultuar** se:

- Qendrat administrojnë **dokumentacionin provues** (shkresor ose në cdo formë tjetër të kërkuar nga ligji) për zgjidhjen e rastit dhe kanë plotësuar **formularët për trajtim kërkesash për ndihmë juridike** parësore sipas formatit të miratuar me 225, datë 25.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.
- **Janë mbajtur dosje të ndara** për çdo rast të trajtuar (për çdo qytetar që ka përfituar ndihmë juridike parësore).
- **Në dosjet e trajtuara është mbajtur proces-verbali** sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Analizë e raporteve mujore narrative

Referuar parashikimeve të metodologjisë së miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga qendrat bazohet në monitorimet tre-mujore të kryera si dhe raportet mujore narrative të përcjella nga ana e punonjësve të Qendrave. Për çdo raport mujor të përcjellë analizohen të dhënat si dhe orientimi ligjor / zgjidhja e rasteve të trajtuara. Gjithashtu, raportet synojnë të adresojnë problematika dhe rekomandime nga ana e punonjësve të qendrave në funksion të përmirësimit të ecurisë së veprimtarisë dhe ofrimit të shërbimit nga ana e tyre.

Konkluzione:

1. Përcjellja e raporteve mujore narrative

Lidhur me përcjelljen e Raporteve Mujore Narrative nga ana e Qendrave të shërbimit të ndihmës Juridike parësore, rezulton se jo të gjitha qendrat i përcjellin për çdo muaj respektiv (raporti është për qendrën dhe jo për punonjës). Vihet re një mungesë bashkëpunimi në këtë kuadër.

2. Punonjësit e qendrave nuk përcjellin problematika / rekomandime

Në raportet mujore rezulton se në pjesën më të madhe të tyre nuk plotësohet rubrika në të cilën pasqyrohen problematika / vështirësi që qendrat hasin në terren dhe rekomandime nga ana e punonjësve. Plotësimi i kësaj rubrike është shumë i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit efektiv dhe marrjes së masave nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike për zgjidhjen e problematikave që përcillen.

3. Numri i ulët i rasteve

Nga raportet e dërguara nga ana e qendrave si dhe nga të dhënat statistikore të përpunuara nga Drejtoria e Politikave sa i përket qendrave parësore, rezulton se nga disa qendra janë trajtuar një numër shumë i ulët rastesh.

Rekomandime:

1. Të merren në konsideratë rekomandimet e dhëna pas çdo monitorimi të kryer

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të marrin në konsideratë rekomandimet që Drejtoria e Mbikëqyrjes ju ka përcjellë përmes raporteve të monitorimit apo komunikimeve të vazhdueshme.

- 2. Fokus i veçantë - rritja e numrit të rasteve të trajtuara dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve**
- 3. Në fokus të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të jetë ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve** për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe kushtet e përfitimit. Ndërgjegjësimi ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e numrit të rasteve të trajtuara.

5.2. Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike dytësore

Në përmbushje të shkronjës “1” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ku përcaktohet se: “Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore”, DNJF ka hartuar kalendarin e mbikëqyrjes për vitin 2021, në të cilin ka detajuar të gjitha monitorimet që do të kryhen përgjatë këtij viti. Lidhur me monitorimin e avokatëve të ndihmës juridike, në kushtet kur lista e re ofruesve të vitit 2021, është publikuar në 1 Mars të këtij viti, DNJF do të vijojë me monitorimin e tyre nga muaji Maj dhe në vijim. Ndërkohë, janë duke u trajtuar të gjitha dosjet e çështjeve të përfunduara të ndihmës juridike si dhe vijon komunikimi i vazhdueshëm me të gjithë avokatët.

6. Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike

Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj përveçse një detyrimi ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017), është një nga komponentët me thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi, DNJF është duke i kushtuar një vemëndje të shtuar zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukimit ligjor të publikut duke hartuar kalendarin e aktiviteteve si dhe një plan konkret pune. Përgjatë funksionimit të saj, DNJF i ka zhvilluar në këtë kuadër disa aktivitete që kanë në fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të publikut jo vetëm duke u përqëndruar tek sistemi i ndihmës juridike falas por duke u ndalur edhe në informimin ligjor të publikut përmes faqes zyrtare të dedikuar të drejtorisë, rrjeteve sociale dhe videove informuese.

6.1 Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura

- Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese “*street law*” nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec, në bashkëpunim me shoqatën “Unë Gruaja”, Janar 2021;
- Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Durrës, me temë “Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve” me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Durrës dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”, Janar 2021;

3. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Shkodër me temë “Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve” me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Shkodër dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”, Janar 2021;
4. Pjesëmarrja në aktivitetin “Ne mundemi-thuaji jo diskriminimit”, nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Shkurt 2021;
5. Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), “Së bashku në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”, Shkurt 2021.
6. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Durrës, me temë “Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve” me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Durrës dhe organizatën jofitimprurëse të autorizuar “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare” dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Mars 2021;
7. Takimi i rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Shkodër me temë “Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve” me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në Shkodër; dorganizatën jofitimprurëse të autorizuar “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare” dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Mars 2021.

6.2 Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjëse/ edukimit ligjor të publikut

1. Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër në televizionin lokal Televizioni RTSH Gjirokastër, Janar 2021;
2. Bashkëpunimi me organizatën jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, QSHPLI MKEZH përmes zhvillimit të një aktiviteti ndërgjegjëses pranë Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër me përfaqësues nga grupe vulnerabel, persona të cilët i përkisnin kategorive të veçanta, përfaqësues nga Bashkia Gjirokastër dhe përfaqësues nga Shtëpia e të Moshuarve, Janar 2021;
3. Realizuar spoti informues në bashkëpunim me UNDP me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në të cilat jepet informacion mbi sistemin e ri të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, kushtet e përfitimit, ofruesit e shërbimit dhe informacione të tjera të nevojshme për informimin ligjor të publikut, Shkurt 2021;
4. Afishimi i posterave dhe shpërndarja e fletëpalosjeve/manualëve të dedikuara për qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Gjirokastër, me qëllim informimin e qytetarëve dhe orientimin e tyre për përfitimin e shërbimeve pranë kësaj qendre, Janar-Mars 2021;
5. Fushata e ndërgjegjësimin në qytetin e Lezhës, Vlorës, Fierit dhe Dibrës, Mars 2021;

(Gjatë muajit mars 2021, ekipi i DNJF organizoi disa fushata ndërgjegjësimi gjatë të cilave u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike).

7. Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

- *Bashkëpunimi me Euralius*

Më datë 18.03.2021 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V dhe Shkollën e Magjistraturës zhvilluan trajnimin online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” Ky trajnim u zhvillua nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Euralius dhe të Shkollës së Magjistraturës Në këtë trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, ofruesit e ndihmës juridike parësore, ofruesit e ndihmës juridike dytësore dhe me praninë e veçantë të gjyqtarëve dhe përfaqësues të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.U diskutua mbi një vështrim të përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe më pas duke u ndalur në terma konkretë dhe raste praktike. Nëpërmjet këtij trajnimi u diskutuan problematikat e hasura nga aktorët kryesorë dhe arrijten e një qëndrimi unifikues në zgjidhjen e tyre.

- *Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore (bashkëpunimi me ASPA, DHASH dhe UNDP)*

DNJF ka patur një komunikim të vazhdueshëm me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me qëllim dakordësimin mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit me trajnim të posaçëm, si detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën “g”, të nenit 8 të ligjit nr.111/2017. Në kushtet kur buxheti i DNJF është i pamjaftueshëm për trajnimin e detyrueshëm e punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF kërkoi nga ana e UNDP mbështetjen për zhvillimin e këtyre trajnimeve, propozim i cili është miratuar dhe pritet që të zhvillohet brenda harkut të 3 mujorit të dytë të këtij viti.

Gjithashtu, bazuar në kompetencat që rrjedhin në nenin 9, gërma “d” të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me mbështetjen e UNDP dhe bashkëpunimin me DHASH, është dakordësuar zhvillimi i një sessioni trajnues më datë 15 Prill 2021.

- *Zhvillimi i Webinareve nga DNJF*

Në kuadër të njohjes së ofruesve të shërbimit me procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore qoftë sa i përket raportimit të të dhënave, qoftë sa i përket procedurës së mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimit, DNJF ka zhvilluar tre uebinare me qëllim diskutimin më në detaje të akteve nënligjore dhe konkretisht:

1. *Webinar me punonjësit e rinj me trajnim të posaçëm pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në qytetet e Fierit, Dibër, Lezhë dhe Vlorë, (Janar 2021).*
Qëllimi kryesor i këtij Uebinari ishte prezantimi i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në terma më konkretë dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit, mbajtjes të të dhënave dhe administrimit të tyre sipas formateve të reja të përcaktuara nga aktet nënligjore.
2. *Trajnim i studentëve të angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve (Shkurt 2021)*

Stafi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me temë “*Akresi në drejtësi dhe risitë e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*”, mbajtur me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrevëshje bashkëpunimi.

Në këtë takim online u trajtuan temat: “*Instrumentët ndërkombëtarë që garantojnë aksesin në drejtësi të qytetarëve ndërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas; Sistemi i ndihmës juridike parësore; Sistemi i ndihmës juridike dytësore; Arritjet e sistemit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmes si dhe parashtrimi i rasteve praktike nga punonjësit i Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë”*.”

Në fund të këtij aktiviteti studentët u pajisën me një vërtetim pjesëmarrjeje si dhe ju bë me dije mundësia për aplikim në kuadër të praktikave 3 mujore të punës (*Prill-Qershor 2021*) pranë DNJF si dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore;

3. *Trajnim online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” (Mars 2021)* Më datë 18.03.2021 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Eurlius V dhe Shkollën e Magjistraturës zhvilluan trajnimin online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” Ky trajnim u zhvillua nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Eurlius dhe të Shkollës së Magjistraturës Në këtë trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, ofruesit e ndihmës juridike parësore, ofruesit e ndihmës juridike dytësore dhe me praninë e veçantë të gjyqtarëve dhe përfaqësues të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.U diskutua mbi një vështrim të përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe më pas duke u ndalur në terma konkretë dhe raste praktike. Nëpërmjet këtij trajnimi u diskutuan problematikat e hasura nga aktorët kryesorë dhe arrijten e një qëndrimi unifikues në zgjidhjen e tyre.

8. Kontribute të DNJF në kuadër të raportimeve për Bashkimin Evropian

DNJF si një institucion i dedikuar sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, është angazhuar që prej fillimit të funksionimit në hartimin e kontributeve të vazhdueshme në kuadër të proceseve që ndiqen me Bashkimin Evropian. Një komponent shumë i rëndësishëm kur flitet për reformën në drejtësi dhe hapat e ndjekura nga Shqipëria në kuadër të procesit të integritit evropian është aksesin në drejtësi, garantimi i qasjes së barabartë për të gjithë shtetasit. Në këtë kuadër, dhe duke patur në vëmendje të veçantë rëndësinë që çdo kontribut i ofruar në këtë drejtim, nga çdo institucion publik është shumë i rëndësishëm që për Shqipërinë, më në fund të celen negociatat me BE, drejtoria është angazhuar maksimalisht në përcjellje të çdo kontributi, përditësimi mbi zhvillimet më të fundit dhe të çdo të dhëne statistikore të kërkuar. Gjatë vitit 2020, disa nga kontributet e dhëna lidhen me:

- Hartimin e kontributit të Qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021_DNJF, (komponenti i ndihms juridike);
- Hartimi i dokumentit IPA III për fushën e EU justice and fundamental rights;
- Raportim i DNJF në kuadër të IPA II për indikatorin nr. 7: “*Shërbimet e ndihmës ligjore falas janë funksionale*”.

9. Angazhim i DNJF në kuadër të dokumentave strategjike (Strategji, plane veprimi, raporte monitorimi)

9.1 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP)

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është një instrument i rëndësishëm me fokus parashikimin e masave konkrete mbi informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve. Është pikërisht Plani i Veprimit në zbatim të kësaj strategjie, dokumenti në të cilin përmbledhen të gjitha aktivitetet dhe masat në përmbushje të objektivave strategjike. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një nga institucionet e përfshira në këtë plan masash.

Në këtë plan janë parashikuar disa masa konkrete që synojnë të mbështesin dhe informojnë komunitetet rome dhe egjiptiane në përputhje me nevojat e tyre. Konkretisht, DNJF ndër të tjera, është përgjegjëse për masat nën objektivin specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike.

Në muajin Janar të vitit 2021, DNJF ka raportuar mbi ecurinë dhe pëmbushjen e masave të ndërmarra në kuadër të edukimit ligjor të publikut për raportin vjetor të monitorimit për vitin 2020.

9.2 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND)

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një nga institucionet që garanton aksesin në drejtësi dhe si e tillë ka një kontribut të rëndësishëm në këtë strategji dhe në zbatimin e saj përmes planit të veprimit. Gjatë kësaj periudhe DNJF është angazhuar në raportim mbi masat e parashikuara në planin aktual të veprimit në zbatim të kësaj strategjie dhe konkretisht në muajin Janar të vitit 2021, DNJF ka raportuar mbi ecurinë dhe pëmbushjen e masave të ndërmarra në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për raportin vjetor të monitorimit për vitin 2020.

9.3 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2020-2023 (SNKK)

DNJF ka dhënë kontribut në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të strategjisë, konkretisht për masën e lidhur me veprimtarinë Task Forcës Antikorrupsion (nën objektivin A.8 të strategjisë). Në funksion të **objektivit A.8** të strategjisë, konkretisht **masa A.8.4**: *“Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë, për zbatimin e së cilës janë përgjegjës/raportues të gjitha institucionet”*.

Duke qenë se në Planin Antikorrupsion të Veprimit është parashikuar si një nga masat e veprimit: **Hartimi i Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet e varësisë brenda vitit 2021**, DNJF ka vijuar me ndërmarrjen e hapave konkretë në përmbushje të kësaj mase. Me Urdhrin nr. 11, datë 10.02.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, është ngritur Grupi i Punës që do të angazhohet në hartimin e Planit të Integritetit për institucionin.

Gjatë këtij tremujori, nga grupi i punës janë ndërmarrë disa hapa në funksion të këtij procesi, konkretisht:

- DNJF ka tashmë disa instrumenta të cilët ndihmojnë në ecurinë e procesit dhe janë një hap i parë drejt hartimit të produktit final (Planit të Integritetit);
- Nga bashkëpunimi me UNDP, DNJF përdor protokollat e komunikimit për ndihmën juridike parësore dhe dytësore, të cilat detajojnë veprimtarinë e institucionit në drejtim të ofrimit të shërbimit;
- Këto dy protokolle komunikimi shërbejnë si hartë procesesh për instucionin, e cila është shumë e rëndësishme në momentin e hartimit të draftit të parë të Planit të Integritetit;
- Gjithashtu, një tjetër instrument i rëndësishëm është Regjistri i Riskut, në të cilin janë adresuar risqe nga të treja drejtoritë pjesë përbërëse të DNJF;
- Strategjia për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti dhe Action Plan, është një tjetër dokument strategjik që ka ndihmuar DNJF jo vetëm në ushtrimin e veprimtarisë; përcaktimin e objektivave dhe vizionit për të ardhmen, por ka ndihmuar gjithashtu edhe në kryerjen e një vlerësimi të rsiqeve kryesore (të grupuara sipas fushave të veprimtarisë).
- Konsultimi me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, është një tjetër pikë që u theksua në këtë takim, duke qenë se DNJF bashkëpunon me disa institucione për të ofruar / garantuar shërbimet ligjore parësore e dytësore falas.

9.4 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për të Miturit (SDM)

Qëllimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2017-2020 në Republikën e Shqipërisë është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për tu ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore administrative apo civile, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të së drejtave të fëmijëve.

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” i ka parashikuar të miturit si kategori të veçanta përfituese. Siç paraqitet në aspektin penal, si në çështjet civile ashtu edhe në atë administrative, të miturit në konflikt me ligjin garantojnë nga një numër i të drejtave procedurale dhe garancive sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2017. Në muajin Janar të vitit 2021, DNJF ka raportuar mbi ecurinë dhe pëmbushjen e masave të ndërmarra në kuadër të edukimit ligjor të publikut për raportin vjetor të monitorimit për vitin 2020.

10. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse (UNDP/EURALIUS/OSFA)

10.1 Bashkëpunimi me UNDP

- Hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore

UNDP është një ndër partnerët kryesorë mbështetës të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me mbështetjen e të cilit janë hapur 8 (tetë) qendra të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Në kuadër të admistrimit të këtyre Qendrave, në muajin Mars 2021, DNJF ka përgatitur raportin për grantin e marrë nga UNDP mbi projektin “Shtrirja e shërbimeve të ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në shqipëri”, Faza e 1-rë e projektit (Korrik 2020-Mars 2021).

-Zhvillimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

Gjithashtu, DNJF bashkëpunon me UNDP edhe në kuadër të trajnimeve për ofruesit e ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Aktualisht jemi në proces të kryerjes së trajnimit për avokatët e rinj sipas listës së ofruesve të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021, (*informacion më i detajuar, gjendet në kreun përkatës*).

10.2 Bashkëpunimi me Euralius

Një ndër partnerët mbështetës të drejtorisë në kuadër të çështjeve të ndihmës juridike falas është EURALIUS, organizatë e cila përgjatë periudhës Janar-Mars 2021, është angazhuar në mbështetje të DNJF në zhvillimin e aktiviteteve si vijon:

-Publikimi i Manualit të Ligjit nr.111/2017, dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij

Qëllimi i këtij manuali është të ofrojë një përmbledhje të koncentruar mbi sistemin e ri të ndihmës juridike dhe udhëzime për zbatimin në praktikë të të gjithë kuadrit ligjor në këtë fushë. Ky manual i është shpërndarë të gjitha Gjykatave të Republikës së Shqipërisë, Dhomave Vendore të Avokatisë; Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore; Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve; Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara; Institucioneve të Pavarura si dhe gjendet i publikuar në faqen zyrtare të DNJF.

-Zhvillimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

Më datë 18.03.2021 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V dhe Shkollën e Magjistraturës zhvilluan trajnimin online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” Ky trajnim u zhvillua nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Euralius dhe të Shkollës së Magjistraturës Në këtë trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ofruesit e ndihmës juridike parësore, ofruesit e ndihmës juridike dytësore dhe me praninë e veçantë të gjyqtarëve dhe përfaqësues të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.U diskutua mbi një vështrim të përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe më pas duke u ndalur në terma konkretë dhe raste praktike. Nëpërmjet këtij trajnimi u diskutuan problematikat e hasura nga aktorët kryesorë dhe arrijten e një qëndrimi unifikues në zgjidhjen e tyre.

10.3 Bashkëpunimi me OSFA

Përmes projektit: “*Ofrimi i ndihmës juridike parësore falas përmes themelimit të dy Qendrave të Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë dhe Elbasan*”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në mbështetje me OSFA është duke administruar qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Tiranë; platformën juristionline.al dhe numrin pa pagesë 08001010.

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë (*pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë*) është një ndër qendrat e para nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, e hapur me mbështetjen e OSFA përmes kontratës së grantit nr. 8432, në kuadër të projektit “*Ofrimi i ndihmës juridike parësore falas përmes Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë*” i vlefshëm për periudhën 03.08.2020-25.02.2021. DNJF, ka patur një komunikim dhe bashkëpunim të

vazhdueshëm me Fondacionin OSFA, qoftë në kuadër të raportimit mbi grantet, qoftë në kuadër të aktiviteteve të tjera të përbashkëta (*platforma juristonline; numri i gjelbër; “case management system” etj.*).

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, në takimin e datës 27.01.2021, me përfaqësues të OSFA, jemi bërë më dije se nga ana e këtij Fondacioni mund të vijohet mbështetja financiare e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë edhe për një periudhë 2 vjeçare, në varësi të miratimit ose jo të projekt-propozimit “*Açessible justice system*” që OSFA ka aplikuar pranë Ambasadës Holandeze në Tiranë. Nëse ky projekt-propozim miratohet, kontrata e re e grantit me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas në kuadër të mrëfksionimit të qendrës Tiranë do të nënshkruhet për periudhën Prill 2021-Prill 2023. Në kushtet kur kontrata aktuale e grantit përfundon në muajin Shkurt 2021, dhe në kushtet më optimale kontrata më e re e grantit do të nënshkruhet në muajin Prill 2021, kjo sjell si pasojë që 3 (tre) punonjësit me trajnim të posaçëm të angazhuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Tiranë, të mbeten pa mbështetje financiare për një periudhë 2-3 mujore. ***Si rrjedhojë nga ana e DNJF janë ndërmarrë të gjitha masat për përcjelljen e projekt propozimit për mbështetjen e Qendrës.***

KREU II- RAPORTIMI DHE MENAXHIMI FINANCIAR

Në zbatim të ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021, në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe në zbatim të kompetencave të parashikuara në ligjin nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në nenin 8, pika b) *DNJF i paraqet Ministrin të Drejtësisë raporte tremujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike; dhe ç) menaxhon fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike*, DNJF:

- ✓ Ka hartuar Rregjistrin e Riskut të DNJF për vitin 2021;
- ✓ Ka hartuar Planin e Punës për periudhën Janar – Qershor 2021;
- ✓ Ka paraqitur Ministrisë së Drejtësisë dhe Degës së Thesarit Tiranë raportime mujore për përdorimin e buxhetit të DNJF;
- ✓ Ka paraqitur Ministrisë së Drejtësisë projekt-buxhetin afatmesëm të DNJF për vitin 2022-2024;
- ✓ Ka hartuar rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2021 dhe ia ka raportuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Degës së Thesarit Tiranë;
- ✓ Marrjen e masave për zbatimin e kontratës së grantit nr. 8432 të dhënë nga organizata OSFA;
- ✓ Marrjen e masave për zbatimin e kontratës së grantit të dhënë nga organizata UNDP.
- ✓ Ka ndihmuar në ndërtimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe planit të saj të veprimit.

Zbatimi i buxhetit në kohë dhe në respektim të përcaktimeve/detyrimeve ligjore, përveçse një faktor orientues, është edhe një instrument stimulues për aktivitetin ekonomik nëpërmjet ekzekutimit të shpenzimeve publike. Realizimi me efektivitet i shpenzimeve buxhetore të programit, tregon një pasqyrë të saktë të shpenzimeve të realizuara.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 DNJF ka hartuar Rregjistrin e Riskut për vitin në fjalë, ka mbyllur raportimet e vitit 2020 që kanë patur afat deri në tremujorin e parë të këtij viti si Raporti i Monitorimit dhe Pyetësi i Vetëvlerësimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Gjithashtu ka mbyllur edhe pasqyrat financiare të vitit që lamë pas.

Në zbatim të kontratave të lidhura me organizatat ndërkombëtare DNJF ka kryer raportimet financiare mbi shpenzimet e realizuara nga fondet e ofruara prej tyre dhe ka bërë të mundur shtyrjen në afat të kohëzgjatjes së kontratës së grantit.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 DNJF ka hartuar Rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve dhe ka arritur të realizojë edhe prokurimin e pajisjeve elektronike në kuadër të fondit të investimeve që i janë akorduar.

DNJF ka hartuar Planin e Punës për periudhën Janar – Qershor 2021, për të patur një organizim më të mirë të detyrave bazuar në prioritetet e tyre dhe në afatet kohore.

Gjithashtu DNJF ka ndihmuar në ndërtimin e Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë për një periudhë 5 vjeçare dhe planit të saj të veprimit, si edhe në plotësimin e Modelit të Kostimit Financiar sipas standarteve IPSIS për objektivat e saj.


Në kuadër të Udhëzimit plotësues nr. 8 datë 03.03.2021, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm” DNJF ka hartuar fazën e parë të Projekt-buxhetit për vitin 2022-2024 duke u bazuar në evidenca të mëparshme hde duke bërë një parashikim real të rritjes së aktivitetit të saj në vitet në vijim.

Vlen për tu theksuar se DNJF, si një drejtori e krijuar rishtazi ka patur mungesë në numrin e punonjësve, përfshirë edhe në stafin drejtues, një pjesë e të cilave kanë arritur të plotësohen gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 dhe jemi ende në proces rekrutimi për plotësimin e vendeve vakante të mbetura.

Një tjetër zë në buxhetin e DNJF ka të bëjë me transfertat për institucionet OJF, ku drejtorja ka shpallur thirrjen për pjesëmarrje. Financimi i OJF me buxhet shteti për kontribut në ofrimin e ndihmës juridike falas është një procedurë që do të zhvillohet për herë të parë këtë vit.


Mëposhtë paraqesim edhe në formë grafiku disa të dhëna financiare të tremujorit të parë:

➤ **Realizimi i fondeve buxhetore:**



➤ **Realizimi I fondeve nga organizatat në formën e granteve:**

REALIZIMI I FONDEVE TË DHËNA NGA ORGANIZAT NË FORMËN E GRANTEVE PËR TREMUJORIN E I - VITI 2021



■ Paga te punonjesve ■ Sigurime shoq.+shend.

KREU III- PËRFUNDIME

- ✓ **Tashmë DNJF funksionon me kapacitet të plotë dhe staf drejtues të rekrutuar** (Në Shkurt të vitit 2021, është bërë i mundur rekrutimi i vendeve vakante të DNJF përfshirë këtu edhe stafin drejtues duke mundësuar kështu realizimin e këtij objekti në masën 100%);
- ✓ **Tashmë janë funksionale dhe operojë dhjetë qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore** (Përgjatë periudhës Janar-Mars 2021 është bërë e mundur hapja/rivitalizimi i 3 qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Fier, Vlorë dhe Dibër (me mbështetjen e UNDP).
- ✓ **Numri i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit shkon në dhjetë.** (Marrëveshja më e fundit e Bashkëpunimit është në Shkurt të vitit 2021, mes Ministrisë të Drejtësisë dhe përfaqësuesit të Universitetit Marin Barleti, pasuar edhe me një aktivitet promovues të Klinikës).
- ✓ **Hapet thirrja për financimin e Organizatave Jofitimprurës të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.** (Në përmbushje të përcaktimeve të VKM nr. 110/2019, DNJF vijoi me shpalljen e thirrjes për aplikime për financim më datë 01 Mars 2021, thirrje e cila mbetet e hapur deri më 15 Prill 2021).
- ✓ **Publikohet lista përfundimtare e avokatëve ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021.** (Nënshkruajnë kontratë me DNJF, 124 avokatë)
- ✓ **Janë janë kryer 5 pagesa të detyrimeve kontraktuale me avokatët që kanë ofruar ndihmë juridike dytësore.**
- ✓ **Është kryer monitorimi tre muajor i dy qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës dhe Lezhë si dhe është planifikuar periudha e monitorimit për avokatët e ndihmës juridike dytësore.**
- ✓ **Janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe mbi 12 aktivitete ndërgjegjësuese dhe takime ndërmjet aktorëve të sistemit të ndihmës juridike me fokus promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.**
- ✓ **Është bërë i mundur trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore përmes zhvillimit të 3 Webinareve nga DNJF dhe organizatat mbështetëse.**
- ✓ **Është dhënë kontributi për raportet vjetore të monitorimit për vitin 2020, për të gjitha strategjitë ku DNJF është e angazhuar (SND; SDM; SELP; SNKK).**
- ✓ **Gjatë këtij tre muajori, kanë përfituar ndihmë juridike parësore 2006 persona.** (577 raste të trajtuara nga qendrat; 612 të trajtuara nga OJF-të; 796 raste të trajtuara online dhe 19 raste të trajtuara nga Klinikat e Ligjit).
- ✓ **Gjatë këtij tre muajori, kanë përfituar ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore 128 persona.** (Totali i vendimeve të administruara është 136 vendime, nga të cilat për këtë periudhë janë rrezuar vetëm 8 kërkesa).